



Plani i Punës së Kolegjiumit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për 2011

I. Strategjia e AKK-së për periudhën 2011-2015

Vizioni dhe misioni i AKK-së i përcaktuar në Strategjinë për periudhën 2011-2015 (të aprovuar nga Bordi i AKK-së) sheh AKK-në në vitin 2015 si organizatë më të fuqishme dhe më efektive në:

1. Avokim në emër të komunave tek niveli qendror, dhe
2. Shërbim të nevojave të komunave anëtare

Me realizim të këtij vizioni dhe misioni do të dëshmohet dobishmëria dhe këmbëngulësia e AKK-së, dhe pritet që komunat do të paguajnë anëtarësinë në tërësi dhe kështu të sigurojnë qëndrueshmërinë financiare të AKK-së.

Rezultatet e pritura nga katër fushat strategjike të veprimit për realizim të vizionit dhe misionit janë:

1. Avokim dhe lobim pro-aktiv

- Interesat e komunave janë promovuar dhe mbrojtur tek qeveria qendrore, agjencionet ndërkombëtare dhe institucionet tjera relevante
- Aktivitetet lobuese janë koordinuar në mënyrë efektive për t'i mundësuar komunave të flasin njëzëri
- Legjislacioni që afekton kompetencat komunale është harmonizuar dhe shërben interesat e komunave

2. Zhvillim efektiv i kapaciteteve

- Koncepti afatgjatë dhe i bazuar në nevoja për zhvillim të kapaciteteve dhe trajnime për komuna është zhvilluar gradualisht dhe është duke u zbatuar
- Trajnim kualitativ i ofruar bazuar në kërkesa specifike të komunave

3. Përmirësim në ofrim të shërbimeve

- Funkcionim efektiv i brendshëm i administratave komunale është përkrahur përmes harmonizimit të strategjive, akteve, organizimit si dhe procedurave relevante komunale të cilat shërbejnë qytetarët dhe sektorin privat
- Ofrim i ekspertizës së kualifikuar teknike dhe ligjore në fushat ku komunat dhe Kolegjiomet nuk kanë ekspertizë të tillë
- Ofrim i shërbimeve specifike komunave të reja që nxisin integrimin
- Ofrim i këshillave të kualifikuara dhe lobim efektiv për financim nga palët e treta

4. Efiçenca organizative

- Në vitin 2015, AKK është një organizatë kompetente, e përparuar dhe financiarisht e qëndrueshme, me leverdi substanciale në procesin e decentralizimit

- Bordi dhe Këshilli i Kryetarëve ofrojnë udhëzime strategjike
- AKK, kryesisht përmes "Miqve të AKK-së", mirëmban marrëdhënie të shkëlqyera me komunitetin e donatorëve ndërkombëtarë

II. Prioritetet e Kolegjiut për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në vitin e kaluar (2010)

1. Implikimi i Kolegjiut në amendamentimin e akteve ligjore në proces;
2. Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira mes komunave të Kosovës për funksionim më të mirë të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në komuna;
3. Angazhimi i Kolegjiut në zgjidhjen e problemeve me nivelin qendror për çështje të caktuara të komunave nga fusha e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.
4. Ndarja e Mirëqenies sociale nga Drejtoria e Shëndetësisë
5. Harmonizimi i akteve ligjore dhe infrastrukturës institucionale në fushën e mirëqenies sociale.
6. Të ndryshohen grantet për Mirëqenie Sociale

III. Projektligjet për vitin 2011 në Strategjinë Legjislative Qeveritare

- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e asistencës sociale në Kosovë- 15 korrik 2011;
- Projektligji për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve publike të punësimit në Kosovë 30 qershor -2011;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare -10 korrik 2011;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/4 për Shëndetësi -1 qershor 2011;
- Projektligji për sigurime shëndetësore -1 qershor 2011;

IV. Plani Vjetor i Punës për vitin 2011

Plani Vjetor i Kolegjiut për vitin 2011 ka për qëllim të:

- organizoj punën e Kolegjiut
- bashkërendoj idetë dhe lehtësoj/udhëheq zbatimin e aktiviteteve
- arrijn e objektivave të Kolegjiut dhe AKK-së, dhe
- kontribuoj në përmirësimin e vetë-qeverisjes lokale në Kosovë

AKK ka organizuar takimin e Kryesisë së Kolegjiut me 03 maj 2011 dhe ka përgatitur Planin e Punës për vitin 2011 ku në vija të trasha janë përcaktuar:

1. 2 prioritete
2. Objektivat
3. Aktivitetet
4. Takimet gjatë vitit 2011

Plani i Punës është në përputhje me i) fushat strategjike të veprimit në kuadër të Strategjisë së AKK-së 2011-2015, ii) prioriteteve të identifikuar për vitin e kaluar 2010, iii) Strategjinë Legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2011, dhe iv) çështjet e ngritura gjatë vizitave të AKK-së në të gjitha Komuna te Kosovës.

Ky Plan i Punës duhet të shihet si një dokument i cili ka nevojë për azhurnim dhe plotësim të vazhdueshëm në mënyrë që t'i përshtatet kërkesave dhe nevojave të komunave të Kosovës sipas situatës në teren.

Plani Vjetor i Punës për vitin 2011 për Kolegjin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

		Takimi 1 27 maj 2011 Mitrovicë	Takimi 2 qershor	Takimi 3 shtator	Takimi 4 nëntor	Takimi 5 ??	Takimi 6
Prioriteti I	Mirëqenia Sociale						
Objektiva I.1	Përfrocimi i funksionalitetit të Kolegjiut në aspektin e shërbimeve sociale						
Aktiviteti I.1.1	Përfrocimi i rolit të Kolegjiut me përkrahje të projektit të DFID-it	Prezantim i projektit					
Aktiviteti I.1.2	Ri-organizimi i Kolegjiut: - Përfshirja e Drejtorëve të Shërbimeve Sociale të Komunave të Prizrenit dhe Mitrovicës në Kolegjiut - Formimi i dy grupeve: i) Shëndetësia udhëhiqet nga Kryesuesi i Kolegjiut, ii) Shërbimet sociale udhëhiqet nga zv. Kryesuesi i Kolegjiut)	X					
Aktiviteti I.1.3	Zhvillimi i Planit të Punës për Shërbime sociale në përkrahje të DFID-it	X		X		?	
Prioriteti II	Shërbimet shëndetësore komunale						
Objektiva II.1	Avancimi dhe kompletimi i infrastrukturës ligjore						
Aktiviteti II.1.1	Amandamenti i ligjit për shëndetësi		X				
Aktiviteti II.1.2	UA për kujdesin primar shëndetësor (pas miratimit të ligjit)			X			
Aktiviteti II.1.3	Përfaqësimi i Kolegjiut në Grupet Punuese legjislative	X					
Objektiva II.2	Decentralizimi dhe zbatimi i kompetencave në fushën e shëndetësisë						
Aktiviteti II.2.1	Rekomandim për decentralizimin e shërbimeve sekondare shëndetësore (përfshirë poliklinikat stomatologjike dhe krijimin e një linje buxhetore relevante)	X			X		
Aktiviteti II.2.2	Sigurimi i buxhetit të mjaftueshëm për ofrimin e shërbimeve shëndetësore		X			?	
Aktiviteti II.2.3	Punësimi i mjekëve të ri (propozim MSH-së për punësimin e mjekëve të ri për së paku 1 vit për tu barazuar me mjeket tjerë për specializim)	X			X		

Raportimi për vitin 2011 dhe planifikimi për 2012